



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

Nr.284, datë 17.07.2023

PËR

**CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATIT SALI HASA, ME
DETYRË PROKUROR NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS
SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SARANDË**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 148/d, pikat 1 dhe 2, germa “b” dhe 3, 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 101, pika 1, germa “a”, 104, pika 3, 105, pika 1, germa “dh”, si dhe 111, pika 1, germa “b” si dhe nenin 157, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 189, pika 1, germa "a", 190, pikat 1 dhe 2, si dhe 192, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 104, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregulloren “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”¹, shqyrtoi Kërkesën nr. 1058/21, datë 15.05.2023, “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, regjistruar me nr. 791/3, datë 16.05.2023, që i përket palëve;

KËRKUES:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

SUBJEKT I PROCEDIMIT:

**Z. Sali Hasa, me detyrë Prokuror në Prokurorinë
pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit
të Përgjithshëm Sarandë**

OBJEKTI:

Fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj
magjistratit Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë

¹ Miratuar me Vendimin nr. 260, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë



Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 111, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (më tej, Këshilli), pasi zhvilloi seancën dëgjimore, shqyrtoi çështjen në përputhje me parashikimet e neneve 142 dhe vijues të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më tej, Ligji për Statusin) si dhe dëgjoi:


- Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (më tej, Inspektori), përfaqësuar nga inspektorja Alma Tafani, sipas Autorizimit nr. 1058/23, datë 15.06.2023 dhe Autorizimit nr. 1058/24, datë 03.07.2023, e cila përfundimisht deklaroi se i qëndron kërkesës së paraqitur;
- Në mungesë të magjistratit Sali Hasa i cili u përfaqësua nga Av. Ermir Dobjani, nga Studio Ligjore “Dobjani Lawyers”, sipas Prokurës së Posaçme Nr. 1305 Rep., Nr. 484 Kol., datë 19.04.2023, i cili përfundimisht kërkoi pezullimin e procedimit disiplinor derisa të shqyrtohet Rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë.

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Më datë 22.06.2021 Këshilli, pasi ka marrë dijeni se, me Vendimin nr. 40, datë 17.06.2021, dhe Vendimin nr. 44, datë 21.06.2021, Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kishte caktuar masën e sigurimit personal “*Arrest me burg*” ndaj magjistratit Sali Hasa, me Vendimin nr. 210, “*Për pezullimin nga detyra të prokurorit Sali Hasa prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*”², ka vendosur pezullimin nga detyra të këtij magjistrati, në bazë të nenit 151 të Ligjit për Statusin.

² <https://klp.al/wp-content/uploads/2021/06/vendim-nr-210-date-22.06.2021.pdf>



2. Pas zhvillimit të procesit gjyqësor, me Vendimin nr. 36, datë 31.05.2022, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur:

- i. Deklarimin fajtor të të pandehurit Sali Hasa, për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
- ii. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën veprë penale.
- iii. Në zbatim të nenit 406/1, të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Sali Hasa i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim.
- iv. Në zbatim të nenit 59, të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vendosur në provë të pandehurin Sali Hasa për një periudhë prove prej 4 (katër) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjatë kësaj kohe, i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte Drejtorinë e Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
- v. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “Arrest me burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit Sali Hasa me vendimin nr.40, datë 17.06.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- vi. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Sali Hasa, nga ambientet e paraburgimit nëse nuk mbahet apo nëse nuk duhet të mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale.
- vii. Në zbatim të nenit 35, të Kodit Penal, të pandehurit Sali Hasa i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një afat prej 5 (pesë) vjet

3. Me Vendimin nr. 18, datë 23.03.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka ndryshuar pjesërisht vendimin e mësipërm, duke vendosur:

- i. Lënien në fuqi të vendimit nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për të pandehurit E. P., N. H., J. Z., M. A. dhe Q. R.
- ii. Ndryshimin e vendimit nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, lidhur me të pandehurin Sali Hasa, si më poshtë:

- iii. Deklarimin fajtor të të pandehurit Sali Hasa për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
- iv. Deklarimin fajtor të të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive,, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
- v. Në aplikim të nenit 55/2 të Kodit Penal, bashkimit e dënimeve dhe dënimit e të pandehurit Sali Hasa me një dënim të vetëm prej 3 (tre) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj burgim.
- vi. Në zbatim të nenit 406/1, të Kodit të Procedurës Penale, dënimit përfundimisht të të pandehurit Sali Hasa me 2 (dy) vjet e 4 (katër) muaj burgim.
- vii. Vuajtja e dënimit do të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme

4. Në zbatim të vendimit të mësipërm është nxjerrë Urdhri i ekzekutimit datë 23.03.2023, i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të ndryshuar me vendimin nr. 18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për të dënuarin Sali Hasa, sipas pjesës përshkruese të këtij urdhri dhe sipas vendimit të formës së prerë.”

5. Inspektori, pasi është njohur me aktet e mësipërme, me Vendimin nr. 1053/1, datë 06.04.2023, “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, ka filluar hetimin disiplinor ndaj magjistratit Sali Hasa, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b”, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, të Ligjit për Statusin, për shkak të dënimit të tij me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal.

6. Sipas Inspektorit, faktet e mësipërme përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 148/d, pika 2, germa “b”, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 104, i Ligjit për Statusin, për shkak se magjistrati Sali Hasa, me vendim të formës së prerë është dënuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal.

7. Në përfundim të hetimit disiplinor, me Vendimin nr. 1058/18, datë 15.05.2023, “Për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, Inspektori ka vendosur:

- i. Përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistratit Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ii. Fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- iii. Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 111, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi.
- iv. Njoftimin e magjistratit Sali Hasa mbi vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj tij.
- v. Dërgimin e Raportit të hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore pranë institucionit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

8. Në përfundim të hetimit disiplinor, me Shkresën me Shkresën nr. 1058/21 prot., datë 15.05.2023, “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, Inspektori i ka kërkuar Këshillit fillimin e procedimit disiplinor dhe marrjen e masës disiplinore ndaj magjistratit në fjalë. Bashkëlidhur me kërkesën, Këshillit i është vënë në dispozicion edhe dosja origjinale përkatëse.

II. RAPORTI I HETIMIT DISIPLINOR DHE ARSYETIMI I INSPEKTORIT NË LIDHJE ME SHKELJET

9. Në kuadër të hetimit disiplinor, Inspektori ka administruar si prova dokumentacionin përkatës nga Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Këshilli, si vijon:

- a) Shkresa nr. 5090/1 prot., datë 11.04.2023 e Prokurorisë së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e protokolluar pranë Inspektorit me nr. 1058/10 prot., datë 11.04.2023, e cila ka vënë në dispozicion vendimin penal nr. 36, datë 31.05.2022, të dënimit të prokurorit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, shkurtim të vendimit nr. 18, datë 23.03.2023 të

- Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe Urdhrit nr. 1162 prot., datë 24.03.2023 *“Për ekzekutimin e vendimit penal nr.36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, që i përket të dënuarit Sali Hasa”*.
- b) Shkresa nr. 982/1 prot., datë 12.04.2023, e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (regjistruar pranë Inspektorit me nr. 1058/13, datë 14.04.2023), e cila ka vënë në dispozicion kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit penal nr. 36, datë 31.05.2022 së bashku me shënimet përkatëse se çfarë ka vendosur Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- c) Shkresa nr. 267/3 prot., datë 11.04.2023, e Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, protokolluar pranë Inspektorit me nr. 1058/12 prot., datë 14.04.2023, ka vënë në dispozicion kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit penal nr. 36, datë 31.05.2022, në ngarkim të të pandehurit Sali Hasa, urdhrin e prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal nr. 18, datë 23.03.2023 dhe urdhrin e prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal nr. 36, datë 31.05.2022, për të dënuarin Sali Hasa.
- ç) Vendimi penal nr. 36, datë 31.05.2022, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- d) Vendimi nr. 18, datë 23.03.2023, i Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- dh) Urdhri i ekzekutimit datë 23.03.2023, i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *“Për ekzekutimin e vendimit penal nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të ndryshuar me vendimin nr. 18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për të dënuarin Sali Hasa, sipas pjesës përshkruese të këtij urdhri dhe sipas vendimit të formës së prerë.”*
- e) Shkresa nr. 791/2 prot., datë 11.04.2023, e Këshillit (regjistruar me nr. 1058/11, datë 13.04.2023 pranë Inspektorit), e cila ka bashkëlidhur Vendimin nr. 210, datë 22.06.2021, *“Për pezullimin nga detyra të prokurorit Sali Hasa”*, të Këshillit.

10. Me Shkresën nr. 1058/2, datë 06.04.2023, Inspektori ka njoftuar magjistratin Sali Hasa, me Vendimin nr. 1058/1, datë 06.04.2023, *“Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”*, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b”, e Kushtetutës si dhe neni 104, i Ligjit për Statusin, për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale *“Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”*, parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal.

Nga ana e Inspektorit, magjistratit i janë njoftuar dhe i janë bërë me dije të drejtat dhe detyrimet e tij sipas ligjit si, e drejta të përfaqësohet vetë ose me anë të përfaqësuesit ligjor, për aksesin në dosjen e hetimit, dorëzimin e parashitësive, për kërkimin e dakordësisë mbi marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet, të

drejtën për t'u njoftuar lidhur me çdo vendim që do të merret gjatë hetimit disiplinor dhe të drejtën e ankimit ndaj këtyre vendimeve.

11. Nëpërmjet mbrojtësve/përfaqësuesve ligjorë të caktuar sipas Prokurës së Posaçme Nr.1305 Rep., Nr. 484 Kol., datë 19.04.2023, subjekti nën hetim disiplinor, magjistrati Sali Hasa ka konfirmuar marrjen dijeni për fillimin e hetimit disiplinor si dhe ka dërguar Parashtrësat e para në lidhje me procedimin disiplinor, rreth shkeljes disiplinore që i atribuohet, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

12. Gjithashtu, gjatë hetimit disiplinor, më datë 04.05.2023, magjistrati ka paraqitur Parashtrësa nr. 2, me lëndë *“Dërgohen kopje të Parashtrësave, memorië dhe dokumente të tjera në mbështetje të pretendimeve të z. Sali Hasa për një proces hetimor të montuar dhe jo objektiv nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykata e Posaçme, në shkelje të parimeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.”*

13. Magjistrati Sali Hasa ka paraqitur pretendime në lidhje me procedimin disiplinor të filluar ndaj tij nga Inspektori, rreth shkeljes disiplinore që i atribuohet duke ngritur pretendime në lidhje me evidentimin e *“shkeljeve të rënda të parimeve të objektivitetit e transparencës në hetimet paraprake të procedimit penal nr. 104/2 të vitit 2021, në ngarkim të të pandehurit Sali Hasa përgjatë hetimeve paraprake nga prokurori A. D., të cilat janë arsye serioze që duhej të bënin që Gjykata e Posaçme të mos ndërmerre Vendimin për arrestimin e tij në datën 19.06.2021, dhe në vijim që Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë të jepte pafajësi për të dy akuzat ndaj z. Sali Hasa”, si dhe “ ... për evidentimin e shkeljes së parimeve të objektivitetit, kontradiktoritetit e transparencës në hetimet paraprake të procedimit penal nr. 104/2 në ngarkim të të pandehurit Sali Hasa, drejtuar në datën 18.02.2022 Gjyqtares, znj. Flojera Davidhi.”*

14. Lidhur me këto pretendime të magjistratit për shkelje të parimeve të objektivitetit, kontradiktoritetit e transparencës në hetimet paraprake të procedimit penal nr. 104/2 në ngarkim të të pandehurit Sali Hasa, nga organi i prokurorisë, etj., Inspektori ka mbajtur qëndrimin se, këto pretendime nuk janë objekt i hetimit disiplinor sipas Vendimit nr. 1058/1, datë 06.04.2023, *“Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”,* të Inspektorit.

Në rastin konkret, shkelja disiplinore e kryer nga magjistrati lidhet me kryerjen e një vepre penale, për të cilën magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë, vendim i cili është vënë në ekzekutim sipas urdhrit përkatës të ekzekutimit.

15. Sipas Inspektorit, rezulton se, magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë sipas Vendimit nr. 18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ndërsa veprimet e konsideruara si shkelje sipas fakteve të pranuar nga

gjkata i përkasin vitit 2021 pra, kanë ndodhur brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit të shkeljes disiplinore.

Pavarësisht këtij parashikimi, sipas ligjit, për shkeljen disiplinore e cila përbën edhe veprë penale, afatet e parashkrimit të shkeljes disiplinore llogariten sipas dispozitave të Kodit Penal. Një nga veprat penale për të cilën është dënuar me burgim magjistrati (neni 319/ç, i Kodit Penal) parashikon dënim me burgim nga 3 deri në 10 vjet. Referuar nenit 66, germa “c”, të Kodit Penal, afati i parashkrimit të ndjekjes penale (*kupto, i hetimit disiplinor*), për veprat penale që parashikojnë dënim nga 5 deri në 10 vjet burgim është 10 vjet. Për rrjedhojë, Inspektori ka konstatuar se, objekti i hetimit disiplinor lidhet me shkelje të kryera nga magjistrati brenda afatit të parashkrimit të tyre.

16. Me qëllim identifikimin e elementëve juridikë dhe faktikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratit subjekt hetimi disiplinor paraprakisht, sipas Inspektorit duhet të analizohen këto çështje: *i) veprimi ose mosveprimi i magjistratit subjekt hetimi disiplinor përbën shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimitarinë e tij profesionale; ii) kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore; iii) llojin e masës disiplinore.*

17. Në nenin 101, pika 1, “shkronja ”a”, të Ligjit për Statusin, parashikohet se:

1. *Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:*
a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.

18. Në nenin 104, të ligjit të mësipërm parashikohen rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit për shkak të kryerjes së një veprë penale. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një veprë penale janë veprimet apo mosveprimet për të cilat magjistrati është dënuar me dënim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Për këto shkelje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin e prokurorisë, masa disiplinore që parashikon ligji është masa e shkarkimit nga detyra.

19. Nga provat e administruara gjatë hetimit disiplinor, rezulton se, me Vendimin nr. 36, datë 31.05.2022, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është vendosur:

Deklarimi fajtor i të pandehurit Sali Hasa, për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 3 (tre) vjet burgim; Deklarimi i pafajshëm i të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja

TEJAK

ose deklarimi i rremë i pasurive,, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën veprë penale; Në zbatim të nenit 406/1, të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Sali Hasa i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim; Në zbatim të nenit 59, të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vendosur në provë të pandehurin Sali Hasa për një periudhë prove prej 4 (katër) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale.....

Me Vendimin nr. 18, datë 23.03.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka ndryshuar pjesërisht vendimin e mësipërm, duke vendosur:

...Ndryshimin e vendimit nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, lidhur me të pandehurin Sali Hasa; Deklarimin fajtor të të pandehurit Sali Hasa për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim; Deklarimin fajtor të të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive,, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim; Në aplikim të nenit 55/2 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin e të pandehurit Sali Hasa me një dënim të vetëm prej 3 (tre) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj burgim; Në zbatim të nenit 406/1, të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit Sali Hasa me 2 (dy) vjet e 4 (katër) muaj burgim; Vuajtja e dënimit do të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme

Në zbatim të vendimit të mësipërm është lëshuar Urdhri i ekzekutimit i datës 23.03.2023, i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të ndryshuar me vendimin nr. 18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për të dënuarin Sali Hasa, sipas pjesës përshkruese të këtij urdhri dhe sipas vendimit të formës së prerë.”

20. Në përfundim të procesit gjyqësor, i pandehuri Sali Hasa është deklaruar fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal dhe për kryerjen e veprës tjetër penale “Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive,, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2, i Kodit Penal.

RETAIN

21. Sipas Inspektorit, ndodhemi përpara veprimeve që kanë cënuar veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë nga veprimet e parregullta të personave të jashtëm por edhe nga veprimet e vetë prokurorit si funksionar i drejtësisë. Veprimet e prokurorit kanë cënuar integritetin e figurës së prokurorit por edhe vetë sistemin e drejtësisë në tërësi sistem i cili ka si qëllim të sigurojë autoritetin, pavarësinë dhe paanësinë në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individëve dhe shoqërisë.

22. Përsa i takon analizës së kriterëve për caktimin e *rëndësisë së shkeljes disiplinore*, në nenin 115, pika 1, të Ligjit për Statusin parashikohen, në mënyrë jo shtruese, si kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore: (a) lloji dhe rrethanat e shkeljes; (b) shkalla e fajësisë dhe motivi; (c) pasojat e shkeljes; (ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; (d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; (dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; (e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; (ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; (f) sjellja e magjistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; (g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme.

23. Në analizë të kriterit *lloji dhe rrethanat e shkeljes*, sipas Inspektorit, nga ana e magjistratit subjekt i hetimit disiplinor janë ndërmarrë veprime aktive me anë të kërkimit dhe marrjes së një shume parash, veprime të cilat përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuara nga neni 319/ç i Kodit Penal, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe me qëllimin përfitimin e padrejtë të kësaj shume, duke favorizuar një palë ndërgjyqëse nëpërmjet dhënies së vendimit. Ndëshkimi i magjistratit me masë disiplinore për kryerjen e një krimi parashikohet nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, i Ligjit për Statusin.

24. Përsa i takon kriterit *shkalla e fajësisë dhe motivi*, referuar Vendimit nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Vendimit nr. 18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas Inspektorit, vepra penale është kryer me dashje direkte me motiv kryesor përfitimin e një shume monetare përkundëjt kryerjes së një veprimi, konkretisht, për të proceduar me paraqitjen e kërkesës për lehtësimin e masës së sigurimit për shtetasin e arrestuar nga prokurori Sali Hasa.

25. Sipas Inspektorit, neni 148/d, pika 2, shkronja “b”, e Kushtetutës parashikon konceptin e shkeljes shumë të rëndë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të prokurorit kur: “b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi”. Ky përcaktim gjen zbatim edhe në nenin 104, pika 3, të Ligjit për Statusin, ku thuhet: “3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për atë që është e nevojshme”, si dhe në nenin 111, pika 1, shkronja “b”, të tij, ku

parashikohet se: “1. Shkarkimi i magjistratit nga detyra jepet si masë disiplinore vetëm në këto raste: b) për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi,”

26. Sipas Inspektorit, për shkak të natyrës së shkeljes së përcaktuar nga Kushtetuta, për të përcaktuar rëndësisë e shkeljes disiplinore nuk është vlerësuar e nevojshme marrja në analizë e kriterëve të tjera të përcaktuara në nenin 115, të Ligjit për Statusin, pasi kjo kuptohet qartë nga ligji themeltar i shtetit, Kushtetuta si dhe Ligji për Statusin (*referuar dispozitave të cituara më sipër*).

27. Për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas Inspektorit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: a) magjistrati duhet të jetë dënuar për kryerjen e një krimi; b) vendimi i dënimit të jetë i formës së prerë.

a) Njëra nga veprat penale, konkretisht, vepra penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal, për të cilën është deklaruar fajtor prokurori Sali Hasa parashikohet si krim. Kjo dispozitë parashikon si vijon: “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionin e tij, dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.”

Në nenin 1, paragrafi 2, të Kodit Penal thuhet se: “Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së Posaçme të këtij Kodi.” Ndërsa, në nenin 32, të këtij kodi parashikohet se: “Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. Për kundërvajtjet penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet.”

Referuar masës së dënimit me burgim që parashikon neni 319/ç, i Kodit Penal dhe këtyre dispozitave rezulton qartësisht se, prokurori Sali Hasa është dënuar me burgim për kryerjen e një krimi (neni 319/ç, i Kodit Penal).

b) Përsa i takon kushtit tjetër, Vendimi nr. 18, datë 23.03.2023, i Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar konsiderohet vendim gjyqësor i formës së prerë referuar nenit 462, pika 3, shkronja “b”, dhe nenit 428, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale.

Ky vendim i formës së prerë është ekzekutuar me Urdhrin datë 23.03.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të ndryshuar me vendimin nr. 18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të



Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për të dënuarin Sali Hasa, sipas pjesës përshkruese të këtij urdhri dhe sipas vendimit të formës së prerë.”

28. Sipas Inspektorit, kryerja e këtyre veprave penale nga ana e magjistratit Sali Hasa ka diskretituar rëndë figurën, autoritetin, dinjitetin si dhe ka dëmtuar rëndë besimin e publikut te figura e magjistratit dhe organet e drejtësisë. Besimi i publikut mbështetet te vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve, sipas neneve 3 dhe 4, të Ligjit për Statusin. Shkelja disiplinore për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi që lidhet me ushtrimin e detyrës është e natyrës së tillë që e bën magjistratin të padenjë të vazhdojë detyrën e prokurorit.

29. Masa disiplinore që caktohet ndaj magjistratit përmbush dy qëllime parandaluese: i) parandalimin e posaçëm në kuptimin që, magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; ii) parandalimin e përgjithshëm në kuptimin që, magjistratët e tjerë të kuptojnë që një sjellje e parregullt nuk duhet kryer pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

30. Në rastin kur, shkelja disiplinore është aq e rëndë sa e bën magjistratin të papërshtatshëm për të vazhduar detyrën e tij, atëherë masa disiplinore nuk mund të ketë më rol të posaçëm edukues. Në këto raste, interesi publik mbrohet duke marrë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 148/d, pika 2, të Kushtetutës, ku thuhet se:

“2. Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës;

b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.”

31. Masa e shkarkimi nga detyra parashikohet edhe në nenin 111, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit, kjo masë disiplinore jepet kur:

a) kur shkelja është shumë e rëndë;

b) kur Këshilli çmon se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin e tij, për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi, për shkak të paaftësisë së rëndë dhe të dukshme, ose për shkak të një sjelljeje që kryhet të paktën me pakujdesi të rëndë, sipas nenit 101, shkronja “b”, të këtij ligji, dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë.

32. Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore, individualizimit dhe proporcionalitetit, Inspektori ka vlerësuar se, në përputhje me shkeljen disiplinore, ndaj magjistratit Sali Hasa duhet të jepet masa disiplinore “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b”, i Kushtetutës dhe nga nenet 104, pika 3, dhe 111, të Ligjit për Statusin.

33. Në përfundim të analizës së mësipërme, me Vendimin nr. 1058/18, datë 15.05.2023, “Për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, Inspektori ka vendosur:

- i. Përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistratit Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ii. Fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- iii. Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 111, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi.
- iv. Njoftimin e magjistratit Sali Hasa mbi vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj tij.
- v. Dërgimin e Raportit të hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore pranë institucionit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

III. PARASHTRIMET E MAGJISTRATIT SALI HASA, QËNDRIMI DHE PROVAT E PARAQITURA PARA KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NË SEANCËN DËGJIMORE

34. Me Shkresën nr. 791/5, datë 30.05.2023, “Njoftohet data e seancës dëgjimore mbi procedimin disiplinor”, prokurori Sali Hasa është njoftuar për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 16.06.2023, ora 11.00. Njëkohësisht, ai është njoftuar mbi të drejtën që, të paktën një javë përpara datës së seancës dëgjimore të paraqesë parashtrimet me shkrim pranë Këshillit, e drejtë e cila nuk është shfrytëzuar në këtë fazë nga magjistrati apo përfaqësuesi ligjor i tij.

35. Rezulton se, në dt. 15.06.2023, pranë Këshillit është depozituar shkresa “Kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore”, e përfaqësuesit ligjor Av. Erajd Dobjani, në Studio Ligjore “Dobjani Lawyers”, regjistruar me nr. 791/11, datë 15.06.2023, pranë Këshillit, me anë të së cilës është kërkuar shtyrja e seancës gjyqësore në një datë tjetër.

36. Në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 16.06.2023, ora 11.00, Këshilli pranoi kërkesën e përfaqësuesit ligjor të z. Hasa, të Av. Erajd Dobjani për shtyrjen e seancës dëgjimore si dhe caktoi datën e seancës tjetër dëgjimore, respektivisht, në dt. 03.07.2023, ora 11.00.

37. Në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 03.07.2023, ora 11.00, magjistrati Sali Hasa u përfaqësua nga mbrojtësi ligjor Av. Ermir Dobjani, i cili paraqiti para Këshillit Parashtrësën me shkrim të përgatitur nga ana e tij si dhe Rekursin ndaj vendimit nr.18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të regjistruar me dt. 16.06.2023.

Në qëndrimin e tij, përfaqësuesi ligjor i z. Sali Hasa, z. Dobjani fillimisht u shpreh se është i bindur në pafajësinë e të përfaqësuarit prej tij duke iu referuar dënimit nga Gjykata e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për vetëm nga njërën nga veprat penale për të cilën ishte akuzuar ndërsa për veprën tjetër dënimi është mbështetur nga vetëm 2 prej 3 anëtarëve të trupit gjykues.

Përfaqësuesi ligjor i z. Sali Hasa kërkoi që, Këshilli të presë përfundimin e shqyrtimit të kërkesës për procedim të Inspektorit, derisa të shqyrtohet Rekursi i paraqitur nga ana e tij në Gjykatën e Lartë me argumentin se, nderi dhe dinjiteti i një magjistrati është themeli i të drejtave të njeriut. Ndër të tjera, ai pretendoi për shkelje të ligjit procedural penal pasi, çështja penale në ngarkim të z. Hasa është marrë në ngarkim nga prokurori i Prokurorisë së Posaçme pa zhvilluar asnjë proces shorti dhe se, hetimi penal ndaj z. Hasa nuk ka qënë objektiv, i paanshëm dhe transparent. Z. Dobjani iu referuar çështjeve penale që u përkasin personave të tjerë (që nuk kanë lidhje me objektin e procedimit disiplinor) dhe kërkoi që edhe Këshilli të ndjekë të njëjtën praktikë në shqyrtimin e këtij rasti.

38. Në përfundim z. Dobjani kërkoi që, Këshilli të vendosë pezullimin e procedimit disiplinor në ngarkim të z. Hasa derisa të përfundojë shqyrtimi i Rekursit të paraqitur në Gjykatën e Lartë. Në cilësinë e provës, ai paraqiti Rekursin e regjistruar me dt. 16.06.2023, kundër Vendimit nr.18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (fotokopje).

IV. VLERËSIMET DHE KONKLuzionET E Këshillit

39. Këshilli, pasi zhvilloi seancën dëgjimore, dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga Inspektori si dhe parashtrimet dhe provën e paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i magjistratit, Av. Ermir Dobjani, arsyeton si më poshtë:

40. Magjistrati Sali Hasa ka ushtruar detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

41. Me Vendimin nr. 40, datë 17.06.2021, dhe Vendimin nr. 44, datë 21.06.2021, Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “*Arrest me burg*”.


42. Për pasojë, me Vendimin nr.210, datë 22.06.2021, “*Për pezullimin nga detyra të prokurorit Sali Hasa prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*”³, Këshilli ka vendosur pezullimin nga detyra të këtij magjistrati pasi, vendosja e kësaj mase sigurimi është shkak kushtetues dhe ligjor për pezullimin nga detyra, bazuar në nenin 148/d pika 4 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenin 151, pika 1, germa “a”, të Ligjit për Statusin.

43. Në përfundim të procesit gjyqësor me të pandehur z. Sali Hasa dhe shtetas të tjerë, me Vendimin nr. 36, datë 31.05.2022, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ndër të tjera, ka vendosur:

- i. *Deklarimin fajtor të të pandehurit Sali Hasa, për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.*
- ii. *Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën vepër penale.*
- iii. *Në zbatim të nenit 406/1, të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Sali Hasa i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim.*
- iv. *Në zbatim të nenit 59, të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vendosur në provë të pandehurin Sali Hasa për një periudhë prove prej 4 (katër) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale. Gjatë kësaj kohe, i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte Drejtorinë e Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.*
- v. *Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale...*
- vi. *Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Sali Hasa, nga ambientet e paraburgimit nëse nuk mbahet apo nëse nuk duhet të mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.*
- vii. *Në zbatim të nenit 35, të Kodit Penal, të pandehurit Sali Hasa i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një afat prej 5 (pesë) vjet*

44. Ndërsa, me Vendimin nr. 18, datë 23.03.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka ndryshuar pjesërisht vendimin e mësipërm, duke vendosur:

³ <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/06/vendim-nr-210-date-22.06.2021.pdf>

- 
- i. Lënien në fuqi të vendimit nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për të pandehurit E. P., N. H., J. Z., M. A. dhe Q. R.
- ii. Ndryshimin e vendimit nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, lidhur me të pandehurin Sali Hasa, si më poshtë:
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Sali Hasa për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
 - Në aplikim të nenit 55/2 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin e të pandehurit Sali Hasa me një dënim të vetëm prej 3 (tre) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj burgim.
 - Në zbatim të nenit 406/1, të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit Sali Hasa me 2 (dy) vjet e 4 (katër) muaj burgim.
 - Vuajtja e dënimit do të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme

45. Në zbatim të vendimit të mësipërm është nxjerrë Urdhri i ekzekutimit datë 23.03.2023, i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. 36, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të ndryshuar me vendimin nr. 18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për të dënuarin Sali Hasa, sipas pjesës përshkruese të këtij urdhri dhe sipas vendimit të formës së prerë.”

46. Në nenin 319/ç, të Kodit Penal parashikohet vepra penale e “Korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, ku thuhet se:

“Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimit i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionit të tij, **dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.**”

Në nenin 257/a/2 të Kodit Penal parashikohet vepra penale e “Refuzimit për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” ku thuhet se: “Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të



zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram, **dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet**”

47. Në nenin 1, paragrafi 2, të Kodit Penal thuhet se: *“Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në cdo rast në dispozitat e pjesës së Posaçme të këtij Kodi.”* Ndërsa, në nenin 32, të këtij kodi, parashikohet se: *“Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. Për kundravajtjet penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet.”*

49. Referuar marzhit të dënimit të parashikuar për veprat penale për të cilat është dhënë dënimi, përkatësisht nenet 319/ç dhe 257/a/2 rezulton se magjistrati është deklaruar fajtor për vepra penale që parashikohen nga ligji si krim.

49. Vendimi nr.18, datë 23.03.2023, i Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar konsiderohet vendim gjyqësor i formës së prerë referuar nenit 462, pika 3, shkronja “b”, dhe nenit 428, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale.

50. Në Nenin 148/d, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet:

“1. Prokurori mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.”

2. Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës;

b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.”

51. Ndërsa, në Nenin 104, pika 3, të Ligjit për Statusin, thuhet se:


“3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për aq sa është e nevojshme.”

52. Neni 111, pika 1, germa “b”, i Ligjit për Statusin, parashikon se:

“1. Shkarkimi i magjistratit nga detyra jepet si masë disiplinore vetëm në këto raste:

a) kur shkelja është shumë e rëndë;

b) kur Këshilli çmon se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin e tij, për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi, për shkak të paaftësisë së rëndë dhe të dukshme, ose për shkak të një sjelljeje që kryhet të paktën me pakujdesi të rëndë, sipas nenit 101, shkronja “b”, të këtij ligji, dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë.”



53. Referuar këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, dënimi për shkak të kryerjes së një krimi me vendim të formës së prerë përbën shkak për marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të magjistratit.

Masa disiplinore “Shkarkim nga detyra” vlerësohet si proporcionale duke patur parasysh që kjo masë jepet për shkak të një dënimi penal për kryerjen e një krimi.

54. Në lidhje me kërkesën e z. Dobjani, si përfaqësues ligjor i z. Hasa, për pezullimin e procedimit disiplinor derisa të përfundojë shqyrtimi i Rekursit kundër Vendimit nr. 18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nga Gjykata e Lartë, shumica e anëtarëve të Këshillit arriti në konkluzionin se kërkesa gjendet e pambështetur në ligj.


Sikurse u citua më sipër neni 148/d, pika 2, shkronja “b”, i Kushtetutës dhe neni 104, pika 3, i Ligjit Për Statusin përcaktojnë se, masa disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj një magjistrati jepet kur ai është dënuar **me vendim gjyqësor të formës së prerë**.

Referuar nenit 462, pika 3, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale, ndër të tjera, janë vendime të formës së prerë: b) vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 428, të këtij Kodi. c) vendimi i Gjykatës së Lartë në rastet e ekstradimit apo transferimit të personave të dënuar...”

Sa më sipër rezulton se Vendimin nr. 36, datë 31.05.2022, i Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i ndryshuar pjesërisht me Vendimin nr. 18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me të cilin magjistrati Sali Hasa është dënuar me burgim për kryerjen e një krimi (sipas nenit 319/ç dhe 257/a/2 të Kodit Penal) konsiderohet *vendim gjyqësor i formës së prerë*, sipas ligjit, për pasojë themi se vendimi plotëson dhe përmbush kërkesat e neneve 148/d, pika 2, shkronja “b”, i Kushtetutës dhe neni 104, pika 3, i Ligjit Për Statusin.

Të vetmet raste kur nga ana e legjislatorit, vendimi i Gjykatës së Lartë është konsideruar si premisë për dhënien e formës së prerë të vendimit të gjykatës më të ulët, janë rastet e ekstradimit apo transferimet e personave të dënuar sipas germës “c”, pika 3, të nenit 462, të K.Pr.Penale, raste të cilat nuk ekzistojnë në çështjen objekt shqyrtimi, për pasojë, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë mbi rekursin e paraqitur nga z. Hasa dhe mbrojtja e tij nuk mund të shërbejë si shkak për pezullimin e procedimit disiplinor.

55. Në përfundim, Këshilli, vlerëson se kërkesa e Inspektorit për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 111, i Ligjit për Statusin, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, pika 3, i Ligjit nr. 96/2016 “Për



statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ndaj magjistratit Sali Hasa duhet pranuar.

56. Në lidhje me pasojat që rrjedhin nga Neni 157, pika 2, i Ligjit për Statusin ku parashikohet se: “...**Nëse magjistrati dënohet për kryerjen e një vepre penale nga gjykata e shkallës së parë ose jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli kompetent, Këshilli mund të pezullojë përfitimin e pagës deri në 50 për qind, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa të vendoset mbi çdo ankim të paraqitur në gjykatën më të lartë...**” nga ana e Komisionit Disiplinor u dakortësua se, me dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistratit Sali Hasa duhet të pezullohet përfitimi i pagës në masën 50% si dhe i përfitimeve të tjera si magjistrat.

PËR KËTO ARËSYE:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 148/d, pikat 1, 2, germa “b” dhe 3, 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 101, pika 1, germa “a”, 104, pika 3, 105, pika 1, germa “dh”, 111, pika 1, germa “b” si dhe nenin 157, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 189, pika 1, germa “a”, 190, pikat 1 dhe 2, si dhe 192, pika 1, të ligjit Nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, të ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregulloren “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 260, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës nr.1058/21 prot, datë 15.05.2023 së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedimin disiplinor, ndaj prokurorit Sali Hasa, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për magjistratin Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
3. Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50 %, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit derisa vendimi të marrë formë të prerë.
4. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit Sali Hasa brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.

5. Për zbatimin e këtij vendimi të njoftohet Prokurori i Përgjithshëm si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4, të ligjit Nr. 8577, dt. 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza



MENDIM PAKICE

Unë, Nurihan Seiti, në cilësinë e anëtares së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës, për shkarkimin nga detyra të subjektit të procedimit disiplinor Sali Hasa me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë (aktualisht i pezulluar nga detyra).


Sikurse rezultoi nga seanca dëgjimore mbrojtësi ligjor i subjektit informoi dhe paraqiti para Këshillit bashkë me parashtrësën me shkrim të përgatitur nga ana e tij dhe Rekursin ndaj vendimit nr.18, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të regjistruar me dt. 16.06.2023.

Duke referuar vendimin Nr 2, datë 03.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mendoj se vendimmarrja përfundimtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në lidhje me masën disiplinore ndaj prokurorit Sali Hasa, duhet të pezullohet deri në shqyrtimin e Rekursit të paraqitur nga subjekti në Gjykatën e Lartë.

Vendimi i sipërcituar i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rikonfirmon pohimin sipas të cilit rekursi në Gjykatën e Lartë përbën mjet të zakonshëm ankimi, shterimi i të cilit e kthen vendimin në formë të prerë në kuptimin e “gjësë së gjykuar”. Për efekt të marrjes së vendimit “gjë të gjykuar” në formën e shterimit të mjeteve të zakonshme të ankimit, Kolegjet e Bashkuara do të kuptojnë disponimin e Gjykatës së Lartë sipas neneve 433 ose 441 (1) (a), 441 (1) (b), 441 (1) (c), 441 (1) (d) të K.Pr.Penale. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se arsytimi i mësipërm rezulton në të njëjtën linjë edhe me interpretimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GjEDNj”). Në vendimet e saj GjEDNj-ja konfirmon se një vendim merr statusin e gjësë së gjykuar (*res judicata*) nëse palët i) kanë shteruar ankimet në rrugë të zakonshme; ose ii) kanë humbur afatet për të paraqitur ankim kundër vendimit të dënimit, duke marrë kështu vendimi formë të parevokueshme.

Posaçërisht, në disa vendime kundër Shqipërisë, GjEDNj-ja ka vendosur shprehimisht se, edhe nëse vendimi i gjykatës së apelit është i ekzekutueshëm, për sa kohë ekziston mundësia për ta apeluar në një gjykatë të një instance më të lartë siç është edhe Gjykata e Lartë, atëherë ai vendim (i gjykatë së apelit) nuk do të konsiderohet si *res judicata*.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerëson se ky qëndrim i GjEDNj-së ka mbetur i pandryshuar dhe është pjesë e praktikës së konsoliduar të asaj gjykate në lidhje me përcaktimin e shprehjes “gjë e gjykuar”. Pra, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë



gjykojnë se shprehja “gjë e gjykuar” (*res judicata*) përkon me shprehjen “formë e prerë” e përdorur nga legjislacioni Shqiptar, për vendimet që marrin këtë status në rastet kur:

- a. Gjykata e Lartë disponon sipas neneve 433 ose 441 (1) (a), 441 (1) (b), 441 (1) (c), 441 (1) (d) të K.Pr.Penale; ose
- b. Palët humbasin afatet e parashikuara në nenet 415(1) dhe 435(1) të K.Pr.Penale mbi paraqitjen e ankimit në gjykatën e apelit ose rekursit në Gjykatën e Lartë.

Duke pasur parasysh faktin se subjekti i procedimit disiplinor është prokuror me një karrierë të gjatë në sistem, prej më shumë se 18 vjet kontribut në sistemin e prokurorisë, mendoj se Këshilli duhet të vlerësojë marrjen e një mase disiplinore vetëm pasi vendimi nr. 18, datë 23.03.2023, i Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të marrë cilësinë e “gjë e gjykuar” (*res judicata*), pas disponimit me vendim nga Gjykata e Lartë. Kjo e parë edhe në këndvështrimin të vendimmarrjes potenciale të Gjykatës së Lartë sipas përcaktimeve të nenit 441 dhe 442 të K.Pr.Penale, e cila mund të prishë vendimin objekt rekursi. Në një situatë hipotetike Këshilli do të duhej të shfuqizonte vendimin e tij për marrjen e masës disiplinore të vendosur nga shumica e anëtareve të tij.

Për këtë shkak bazuar edhe në nenin 66, pika 1 e K.Pr. Administrative i cili parashikon se: *“Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”,* mendoj se procedimi disiplinor i zhvilluar ndaj prokurorit Sali Hasa, duhet të pezullohej deri në shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga subjekti në Gjykatën e Lartë.

ANËTAR
Nurihan Seiti

